



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.85/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike e Kosovës, paraqitur kundër kandidatit për kryetar të Shtimes nga rradhët e Levizjës Vetëvendosje (LVV), Qemajl Aliu, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës me seli në Prishtinë, ZLAnr.85/2025 datë 30.09.2025.

II. Subjektit politik Levizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, Zgjedhjet Lokale 2025 që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 2,000.00 Euro (dymijë Euro).

III. Subjektit politik Levizja Vetëvendosje (LVV) Detyrohet që gjobën e shqiptuar si në pikën -II të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

IV. Urdhërohet Subjektit politik Levizja Vetëvendosje (LVV), që nga momenti i marrjes së këtij vendimi ta largoj nga faqen zyrtare të Komunës së Shtimes në Facebook postimin e shpërndarë të datës 29.09.2025.

A r s y e t i m

Me datën 30.09.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Partia Demokratike e Kosovës, paraqitur kundër Qemajl Aliu, kandidat për kryetar të Komunës në Shtime, nga radhët e Subjektit Politik Levizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Shtime, për shkak të shkeljes së Kodit

të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, duke shfrytëzuar burimet dhe institucionet publike shtetërore, për qëllime elektorale për fushatë personale.

Më tej në ankesë thuhet se kandidati në fjalë ka shfrytëzuar faqen zyrtare të Komunës së Shtimes në Facebook ku ka publikuar një postim lidhur me garën e motocross-it të mbajtur në fshatin Mollopolc (Shtime) . Në përmbajtjen e videos së publikuar është përfshirë fotografia dhe slogani elektoral i kandidatit për kryetar nga LVV në Shtime , Qemajl Aliu , me mbishkrimin “Vazhdojmë transformimin- Qemajl Aliu”.

Parashtruesi i ankesës thekson se ky veprim bie ndesh me legjislacionin zgjedhor në fuqi Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme , neni 4 , par.1.7, përcakton së “ përdorimi i zyrave publike , burimeve ose personelit të cilitdo institucion në nivel qendror ose lokal me qëllim të mbështetjes së një subjekti politik në zgjedhje është rreptësisht i ndaluar”

Si provë, parashtruesi i ankesës , ka bashkangjitur linkun e postimit në rrjetin social Facebook bashkë me CD : <https://www.facebook.com/share/p/1Fio7Sqr6o/>

Në përgjigjen në ankesë të datës 30.09.2025, të subjektit politik LVV theksohet se videoja e postuar në Facebook nga Komuna e Shtimes, paraqet organizimin e garës së motorcross-it në fshatin Mollopolc, ku shihet kryetari aktual i Komunës z.Qemajl Aliu, në kapacitetin e tij të kryetarit të Komunës. I njëjti shihet duke hapur garën. Brenda videos, nuk figuron asnjë slogan me titullin: "Vazhdojmë transformimin - Qemajl Aliu", por figuron vetëm togfjalëshi "Vazhdojmë Transformimin", si mbishkrim i cili flet për progresin e shënuar të Komunës në vazhdimësi. Asnjëherë më parë kjo Komunë nuk ka organizuar gara të një cilësie të këtillë apo të një sporti kaq atraktiv, i cili njëkohësisht Komunën e bën më progresive dhe më atraktive shikuar nga këndvështrimet e ndryshme. Pra, nuk ka asgjë personale e z.Aliu, kandidatit të Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të kësaj komune, lidhur me organizimin e motorcross-it e aq më tepër, paraqitjes së kësaj gare në rrjetin social Facebook nga faqja zyrtare e Komunës së Shtimës. Po ashtu, Lëvizja Vetëvendosje shton se askund nuk figuron që slogani i Qemajl Aliut në zgjedhjet lokale është "Vazhdojmë Transformimin - Qemajl Aliu". Për më tepër, në postimin e atakuar shkruan "Vazhdojmë Transformimin", e as kjo nuk është motoja zyrtare e z.Aliu. Sllogani i Lëvizjes Vetëvendosje në zgjedhjet lokale është "Bashkë", dhe nga z.Aliu si kandidat për Shtimen përdoret sllogani "Bashkë për Shtimen".

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pasi shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, ka gjetur se nga provat materiale e bashkangjitur ankesës, të Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, dhe shkresave tjera të lëndës, është vërtetuar se Qemajl Aliu, kandidat për kryetar të Shtimes nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka shfrytëzuar rrjetin social Facebook zyrtar të Komunës së Shtimes ku

është e përfshirë fotografia dhe slogani elektoral i kandidatit për kryetar nga Lëvizja Vetëvendosje në Shtime , Qemajl Aliu , gjithashtu në postimin e bërë është shkruar “ mbështetjen e fuqishme për klub e garave nuk do ta ndal as gjatë mandatit të ardhshëm”, me qëllim të përfitimit të votave nga qytetarët e Shtimes.

Bazuar në këtë i njëjti ka shkelur dispozitën e nenit 36 paragrafi 1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “*personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë te nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje ne zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje*”.

Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e Qemajl Aliu, kandidat për kryetar të Shtimes nga subjekti politik Levizja Vetëvendosje (LVV), bien ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që i njëjti me këto veprime-kërkesa ndaj qytetarëve të Shtimes ka pasur qëllim të vetëm përfitimin e votave në zgjedhjet lokale që do të mbahen me 12 tetor 2025.

Paneli, me rastin e vendosjes së lartësisë së dënimit si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e rregullave zgjedhore që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, ku i është shqiptuar dënimi më gjorbë në lartësi prej 2,000.00 euro, (dymijë Euro).

Nga arsyet e theksuara me lartë, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.85/2025 më datën 03.10.2025

Kryesues i Panelit,
Skender Çoçaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.